



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë  
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade



# RAPORT VJETOR 2023

Adresa: Rruga "Arbënor e Astrit Dehari" nr. 21, 10000 Prishtinë/Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 200 36 554  
Web: [www.kipa.rks-gov.net](http://www.kipa.rks-gov.net)

## **Përmbajtje**

|   |    |
|---|----|
| <u>Hyrie</u>  | 3  |
| <u>Pranimi aplikimeve dhe kërkesave nga palët</u>               | 4  |
| <u>Ekzaminimi i aplikimeve dhe shqyrtimi i kërkesave</u>        | 5  |
| - Patenta   |    |
| - Marka Tregtare  |    |
| - Dizajnet Industriale  |    |
| <u>Shqyrtimi i kundërshtimeve të markave tregtare</u>           | 10 |
| <u>Publikimi i Buletinit Zyrtarë të Agjencisë</u>               | 11 |
| <u>Digjitalizimi i Agjencisë</u>                                | 12 |
| <u>Treguesit Gjeografikë dhe Emërtimet e Origjinës</u>          | 13 |
| <u>Infrastruktura ligjore në fushën e pronësisë industriale</u> | 14 |
| <u>Aktivitetet për promovimin e pronësisë industriale</u>       | 14 |
| <u>Forcimi i kapaciteteve të zyrtarëve të Agjencisë</u>         | 20 |
| <u>Të hyrat financiare</u>                                      | 22 |
| <u>Të arriturat kryesore</u>                                    | 22 |
| <u>Donatorët mbështetës</u>                                     | 23 |
| <u>Kontakti</u>   | 24 |

## Hyrje

Agjencia për Pronësi Industriale (API) është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë për Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti dhe është institucioni i vetëm i ngarkuar në Kosovë për administrimin dhe promovimin e të drejtave të pronësisë industriale, detyrim i cili buron nga neni i 46 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Kjo agjenci përfaqëson pikën e vetme shtetërore në Kosovë për mbrojtjen e markave tregtare, patentave, dizajneve industriale, treguesve gjeografikë dhe topografive të produkteve të gjysmëpërçues. Përmes proceseve të regjistrimit, API siguron pronarëve të drejtat e duhura mbi pronësinë e tyre industriale, duke vepruar në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe Acquis e BE.

API ka një rol kyç në zbatimin e Kapitullit VII të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, ku Kosova angazhohet për të mbrojtur dhe zbatuar të drejtat e pronësisë intelektuale. Misioni kryesor i saj është të rrisë mbrojtjen e pronësisë industriale në territorin e Kosovës dhe të promovojë respektimin e kësaj lloji pronësie, duke u bazuar në legjislacionin vendas dhe ndërkombëtar.

Në këtë raport vjetor, API paraqet detajet e punës së saj, sfidat që ka përballur dhe përpjekjet për të rritur ndërgjegjësimin e publik rreth rëndësisë së pronësisë industriale në Kosovë. Me ndërgjegjësimin e rritur rreth rëndësisë së pronësisë intelektuale në tregun global, Agjencia është e përkushtuar të avancojë dhe të përmirësojë sistemin e pronësisë industriale në vend, duke përfshirë arritjen e objektivave strategjike.

Ky raport i detajuar ofron një pasqyrë të hollësishme të lëndëve të pranuar, efikasitetit të stafit të Agjencisë, gamës së shërbimeve të ofruara, si dhe aktiviteteve që janë ndërmarrë për të forcuar kapacitetet administrative dhe promovimin e pronësisë industriale në Kosovë.

Duke ju dëshiruar vit të mbarë

JU FALENDEROJMË

## 1. Pranimi i aplikimeve dhe kërkesave tjera nga palët


Agjencia për Pronësi Industriale ka vazhduar me angazhimin e saj në pranimin e kërkesave për objekte të pronësisë industriale, përfshirë Markat Tregtare, Patentat, Dizajnet Industriale, kundërshtimet e markave të publikuara, hulumtimet e markave tregtare, ekzaminimet paraprake, vazhdimet e markave tregtare, ndryshimet në regjistër, kërkesat mirëmbajtjen e patentave, dokumentacionet e përparësisë, autorizimet e përgjithshme, ankesat në komisionin e ankesave, vendimet e komisionit të ankesave dhe dokumentacionet tjera.

Në këtë periudhë kohore, në zyrën e pranimit të dokumentacionit të API-së, janë regjistruar **8423** kërkesa të ndryshme, të cilat janë analizuar dhe reflektuar në tabelën e mëposhtme:

| <b>Tabela e kërkesave të pranuarra për vitin 2023</b>  |             |
|--|-------------|
| Marka Tregtare aplikime  | <b>1845</b> |
| Patenta aplikime   | <b>19</b>   |
| Dizajn Industriale aplikime  | <b>65</b>   |
| Kërkesa për vazhdime të markave tregtare   | <b>936</b>  |
| Kërkesa për ndryshime në regjistër të markave tregtare, patentave dhe dizajneve industriale  | <b>1163</b> |
| Kërkesa për plotësime të Markave Tregtare, taksa për lëshimin e vendimit dhe taksa për lëshimin e certifikatës për Marka Tregtare, pagesa të patentave dhe dizajnit industrial | <b>2894</b> |
| Kërkesa për ekzaminimin e parakohshëm të markave tregtare  | <b>4</b>    |
| Autorizime   | <b>121</b>  |
| Kërkesa për mbajtje në fuqi të patentave   | <b>188</b>  |
| Kundërshtime të Markave Tregtare   | <b>119</b>  |
| Kërkesa për heqje dorë të markave tregtare dhe patentave   | <b>28</b>   |
| Kërkesa për ekstrakt regjistri   | <b>5</b>    |
| Kërkesa për vazhdimin e dizajnit industrial  | <b>18</b>   |
| Dokumente prioriteti   | <b>137</b>  |
| Kërkesa për informacione të markave tregtare dhe patentave   | <b>14</b>   |
| Mirëmbajtje vjetore të licencës së përfaqësuesve   | <b>37</b>   |
| Ankesa kundër vendimeve të API-së  | <b>25</b>   |

|   |     |
|---|-----|
| Vendim i komisionit të ankesave                             | 19  |
| Kërkesa për rivendosje të MT                                | 9   |
| Kërkesa nga pala dhe kërkesa për përmirësimin               | 227 |
| Vërejtje kundër markës së publikuar                         | 25  |
| Kërkesë për shfuqizim vendimi dhe revokim                   | 6   |
| Dokumenti i ri  | 374 |
| Përgjigje në kërkesën për kundërshtimin e MT                | 96  |
| Kërkesë për kufizimin e listës së produkteve dhe shërbimeve | 26  |
| Kërkesë për licencë të markës tregtare dhe regjistrim pengu | 8   |
| Tërheqje të kundërshtimit të markave tregtare               | 12  |
| Vendime të Gjykatës   | 3   |

Tabela 1. Numri i dokumenteve hyrëse, Dhjetor 2023




## 2. Ekzaminimi i aplikimeve / shqyrtimi i kërkesave

### Patenta

Numri i aplikimeve për patenta është ende në një nivel të ulët, kryesisht për shkak të mos-anëtarësimit të Kosovës në Zyrën Europiane të Patentave (EPO) dhe mungesës së një industri inovative që të inkurajojë aplikimin e patenteve me origjinë vendase. Nëse anëtarësohet në EPO, pritet të shihet një rritje e numrit të aplikimeve për patenta, pasi kjo do të reduktojë koston dhe kohën e procesit të aplikimit në krahasim me procedurat aktuale të mbrojtjes në nivel kombëtar në Kosovë.

Për çështjen e ekzaminimit të kërkesave për patenta, ky proces zhvillohet brenda 18 muajve nga data e paraqitjes së kërkesës. Pas marrjes së patentës, pronari i saj duhet të ofrojë një dëshmi shkrimore që shpikja është e tij, është e re dhe ka kap shpikës, duke filluar nga fundi i vitit të nëntë të afatit të patentës të caktuar nga Agjencia.



|   |             |
|---|-------------|
| Njoftim për plotësimin e aplikacioneve për patentë  | <b>15</b>   |
| Njoftim për pagesën e tarifave për lëshimin e vendimit për njohje   | <b>11</b>   |
| Vendim për njohjen e patentës   | <b>9</b>    |
| Vendim të tërësishme – pjesërisht të patentave  | <b>4</b>    |
| Vendime për ndryshim në regjistrin e patentave  | <b>33</b>   |
| Hapa në sistemin IPAS   | <b>4124</b> |
| User doc acceptance, pranimi i mbajtjeve në fuqi pas kontrollimit, dhe i dokumenteve tjera përcjellëse të hyra si user dokumente për aplikimet dhe regjistrin e patentave | <b>200</b>  |
| Mbatje në fuqi të kontrolluara dhe chekuara   | <b>195</b>  |
| Vendime për refuzimin e patentave   | <b>5</b>    |


Tabela 2. Statistika vjetore të sektorit të patentave 2023

### Marka Tregtare

Numri i aplikimeve për marka tregtare ka qëndruar stabil, duke ruajtur një trend të qëndrueshëm dhe mesataren e përgjithshme të aplikimeve në të kaluarën.

Agjencia për Pronësi Industriale ka vazhduar me përpunimin dhe shqyrtimin e kërkesave për marka tregtare. Deri tani, shqyrtimet e aplikimeve paraprake janë kompletuar me sukses, dhe puna vazhdon me të njëjtin dinamizëm për të shqyrtuar aplikimet e reja të markave tregtare që janë pranuar gjatë vitit 2023.


Deri tek regjistrimi i një marke tregtare e cila nuk pranon kundërshtim gjatë publikimit, Agjencia duhet të ndjekë disa hapa, si: ekzaminimi formal i aplikacionit për markë tregtare, ekzaminimi lidhur me bazat absolute të refuzimit, publikimi i aplikimit, lëshimi i ftesën për pagesën e regjistrimit dhe në fund lëshimi i vendimit për regjistrimin e një marke tregtare. Regjistrimi i një marke tregtare në Agjenci për aplikimet të cilat nuk pranojnë kundërshtime bëhet në kohë relativisht të shpejtë krahasuar me kohën e ekzaminimit të aplikimeve nga vendet rajonale apo të tjera.



|   |             |
|---|-------------|
| Vendime për regjistrimin e markave tregtare   | <b>2334</b> |
| Publikime të markave tregtare pas ekzaminimit   | <b>1735</b> |
| Njoftime për plotësimin e aplikacioneve   | <b>9</b>    |
| Njoftime për heqje dorë të markave tregtare   | <b>35</b>   |
| Vendime për ndryshimin në regjistër të markave tregtare dhe përfaqësuesve të autorizuar | <b>872</b>  |
| Vendime për vazhdimin e markave tregtare  | <b>964</b>  |
| Lëshimi i certifikatave për marka tregtare  | <b>2135</b> |
| Ftesë për pagesën e vendimit për markë tregtare   | <b>2458</b> |
| Ekstrakte regjistri   | <b>20</b>   |
| Vendime për refuzimin e MT  | <b>72</b>   |
| Ftesa për përgjigje në kundërshtimin e markave tregtare                                 | <b>172</b>  |
| Vendime shqyrtimin e kundërshtimeve të markave tregtare                                 | <b>246</b>  |

*Tabela 3. Statistika vjetore të sektorit të markave tregtare për vitin 2023*

Grafikoni i mëposhtëm tregon numrin e regjistrimit të objekteve industriale në vite, ku në krahasim me vitin 2022 kemi një rritje prej **50.38%** të numrit të regjistrimeve të markave tregtare




### Dizajni Industrial

Për dallim nga vitet paraprake, gjatë vitit 2023 kemi një rritje të numrit të aplikimeve për dizajn industrial. Me dizajn industrial mbrohet dukja e jashtme e produktit. Produkti duhet të ketë karakter individual dhe të jetë i ri në fushën përkatëse.

|  |           |
|--|-----------|
| Njoftime për plotësimin e Dizajnit Industrial  | <b>12</b> |
| Vendime për vazhdimin e Dizajnit Industrial    | <b>12</b> |
| Vendime për regjistrimin e Dizajnit Industrial | <b>39</b> |
| Certifikata për Dizajnin Industrial            | <b>7</b>  |
| Ftese për pagesën e regjistrimit të DZ         | <b>38</b> |

Tabela 4. Statistika vjetore të dizajnit industrial 2023






## Përmbledhja statistikore e punës vjetore

Agjencia për Pronësi Industriale ka vazhduar me shqyrtimin e kërkesave të palëve të pranuar gjatë këtij viti, ku në këtë viti kemi një rritje të veprimeve në sistemin IPAS të cilat përkthehen në më shumë kërkesa të trajtuara të palëve.


Nga të dhënat statistikore të nxjerra në sistemin IPAS del se zyrtarët e API-së gjatë vitit 2023 kanë kryer gjithsejt **31676** hapa në sistem. Hapat përfshijnë kalimin nga një procedurë e ekzaminimit në procedurën tjetër.



Gjatë këtij viti janë skanuar, indeksuar dhe dërguar në server **17300** shkresa hyrëse dhe dalëse, që e bën procesin e pranimit dhe lëshimit të dokumenteve të nga forma elektronike shumë me te lehte dhe shpejte.

Janë lëshuar **9452** dokumente dalëse, vendime, certifikata, ftesa, për përfundimin e proceseve të shqyrtimit të aplikimeve apo **30.03%** më shumë dokumente të lëshuara në krahasim me vitin paraprak.


Numri i dokumenteve zyrtare të lëshara nga API



### 3. Kundërshtimet e regjistrimit të markës tregtare

Agjencia për Pronësi Industriale për herë të parë në historinë e saj ka filluar me shqyrtimin e kundërshtimeve për marka tregtare. Pas krijimi të grupit të zyrtarëve dhe trajnimit të tyre, API ka filluar me shqyrtimin e tyre, ku gjatë këtij viti ka nxjerrë **246** vendime për shqyrtimin e kundërshtimeve. Shqyrtimi i kërkesave për kundërshtime konsiderohet pjesa më profesionale dhe e vështirë ku Agjencia shqyrton ngjashmëritë në mes të 2 markave tregtare të cilat janë në konflikt.

Numri i kundërshtimeve të zgjidhura



#### 4. Publikimi i Buletinit të Agjencisë

Agjencia për Pronësi Industriale gjatë këtij viti ka publikuar **7** Buletine Zyrtare me **9306** objekte të pronësisë industriale të cilat përfshijnë: aplikime të markave tregtare, vendime për regjistrimin e markave tregtare, ndryshimet në regjistër, vazhdimet e markave tregtare, regjistrimet e patentave dhe dizajnit industrial.

Duke u mbështetur në buletin, pronarët e markave të mëhershme të cekur në nenin 34 të Ligjit për Marka Tregtare Nr. 08/L-075 mund të paraqesin kundërshtimet e tyre. Këto kundërshtime duhet të dorëzohen brenda periudhës kur Buletini Zyrtar është i hapur apo brenda 3 muajve nga data e publikimit të Buletinit Zyrtar.

Përveç Buletinit, Agjencia në ueb faqen e saj publikon dhe regjistrin online ku publiku mund të kërkojë për objekte të pronësisë industriale dhe aplikuesit mund të shikojnë procesin e shqyrtimit të aplikacionit të tyre.

Linku për qasje në Buletinet Zyrtare të Agjencisë <https://kipa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,47>



## 5. Digjitalizimi i API-së, Sistemi IPAS, WipoScan, WipoPublish dhe Web faqe

Ka vazhduar përditësimi i regjistrimit online për objektet e pronësisë industriale. Ky regjistër përditësohet çdo ditë kalendarike. Sipas legjislacionit, markat tregtare publikohen nga momenti i aplikimit ndërsa patentat dhe dizajnet industriale publikohen në regjistër vetëm pas regjistrimit dhe publikimit të tyre në Buletinin Zyrtar.



The screenshot displays the website of the Kosovo Intellectual Property Agency (KIPA). The main heading is "SISTEMI I KËRKIMIT TË AGJENCISË PËR PRONËSI INDUSTRIALE" (Industrial Property Search System). Below this, it specifies "PATENTA, DIZAJN INDUSTRIALË DHE MARKAT TREGTARE TË DEPOZITUARA NË KOSOVË". The interface shows search filters for "Flamuri" (Flag) and "Shteti" (Country), both set to "Kosova". The search results are summarized in three buttons: "Patenta" with 1005 results, "Dizajn" with 35 results, and "Marka Tregtare" with 35613 results. The footer includes the WIPO logo, a search bar labeled "KËRKO" (Search), and an "EXPORTO" (Export) button. The version number "1.5.2" and "powered by WIPO" are also visible.

Ky sistem i ofruar nga WIPO mundëson që palët të bëjnë kërkime për marka tregtare dhe të shohin statusin e aplikimeve të tyre, kjo krijon transparence tek palët pasi ato mundën në çdo kohë të verifikojnë rrjedhjen e shqyrtimit të lëndës së tyre.

API gjatë vitit 2023 ka publikuar aktivitetet kryesore në web faqen e saj, janë krijuar **20** lajme dhe publikuar në web faqen [www.kipa.rks-gov.net](http://www.kipa.rks-gov.net).

Për informimin e publikut për pronësinë intelektuale, është aktive dhe web faqja në të cilën janë të përmbledhura të gjitha informatat mbi pronësinë intelektuale, <https://www.pronesiaintelektuale.com/sq>.

## 6. Treguesit Gjeografikë dhe Emërtimet e Origjinës

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përkatësisht Agjencia Për Pronësi Industriale, për herë të parë në Republikën e Kosovës, ka nxjerrë vendim për mbrojtjen produkteve vendore të Djathit të Sharrit dhe Verën e Rahovecit me tregues gjeografikë, duke u bazuar në Ligjin Për Treguesit Gjeografik dhe Emërtimet e Origjinës.

Fakti se "Djathi i Sharrit" dhe verëra e Rahovecit janë një prodhim unik i rajoneve dhe karakteristikave të kulturës, tokës dhe mjedisit që janë të lidhura me emërtimin, pas vendimit për ta mbrojtur si emërtim i origjinës i bën këto produkte krenari kombëtare.

Treguesi Gjeografik, në këtë rast "Djathi i Sharrit" dhe "Verëra e Rahovecit" të mbrojtur, kanë një rëndësi të veçantë për zhvillimin e sektorit ekonomik të djathit dhe verës në Kosovë duke promovuar turizmin rural. Bjeshkët e Sharrit duke qenë rajon ndërkufitar ia shtojnë edhe më tepër rëndësinë këtij produkti duke e bërë Kosovën si vendin e parë që mbron një produkt me këtë emërtim.



## 7. Infrastruktura ligjore

Gjatë këtij viti janë miratuar 4 Udhëzime Administrative për implementimin e ligjeve të pronësisë industriale. Me miratimin e këtyre akteve nënligjore, është kompletuar infrastruktura ligjore në fushën e pronësisë industriale. Udhëzimet Administrative të miratuara gjatë këtij viti kalendarik janë:

- Udhëzimi Administrativ Nr. 01-2023 për Caktimin e Taksave për Shërbimet e ofruara nga Agjencia për Pronësi Industriale;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 08-2023 për Procedurat e Regjistrimit të Markave Tregtare;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 03-2023 për Procedurat e Regjistrimit të Dizajneve Industriale;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02-2023 për Procedurën e Regjistrimit të Topografive të Produkteve të Gjysëmpërquesve

## 8. Aktivitetet për promovimin e pronësisë industriale

Agjencia për Pronësi Industriale mori pjesë në takim për prezantimin e strategjisë për zhvillimin industrial dhe dialogun e zhvilluar me biznesin privat. Në këtë takim ku morën pjesën një numër i bizneseve rajonale ndër të tjera u promovua mbrojtja e pronësisë industriale. Bizneset pjesëmarrëse u informuan mbi rëndësinë e mbrojtjes së identitetit të tyre përmes regjistrimit të markave tregtare, shpikjeve apo formave inovative të produkteve të tyre.



U mbajt një ligjërate me studentët e Kolegjit AAB për të Drejtat e Pronësisë Intellektuale me theks rëndësinë e mbrojtjes së IP, dhe si IP mund të inkurajojë investimet në kërkim dhe zhvillim.



Agjencia për Pronësi Industriale së bashku me Zyrën për të Drejtat e Autorit mbajtën një sesion informimi me nxënësit e Innovation Academy.



Agjencia për Pronësi Industriale së bashku me Zyrën për të Drejtat e Autorit mbajtën seminarin me bizneset e Odës Amerikane të Kosovës. Në këtë seminar u diskutua mbi pronësinë intelektuale në veçanti për "Si të mbron identitetin tuaj të biznesit nga konkurrentët përmes pronës intelektuale".



Agjencia për Pronësi Industriale së bashku me Zyrën për të Drejtat e Autorit mbajtën seminarin me bizneset e Odës Ekonomike të Kosovës. Në këtë seminar u diskutua mbi pronësinë intelektuale në veçanti për "Si të mbroshi identitetin tuaj të biznesit nga konkurrentët përmes pronës intelektuale".





Agjencia për Pronësi Industriale së bashku me Zyrën për të Drejtat e Autorit morën pjesë në 3 aktivitete të ndara për promovimin e pronësisë intelektuale në mediat elektronike. Promovimet u mbajtën në RTK, RTV 21 dhe ATV, ku përfaqësuesit e 2 zyrave folën për rëndësinë e mbrojtjes së pronësisë intelektuale.



Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kanë shënuar Ditën e Inovacionit dhe Ditën ndërkombëtare të Pronësisë Intelektuale me temën “Gratë në Inovacion dhe Kreativitet”.



Shënimi i Ditës Botërore për Pronësi Intelektuale u bë në Innovation Centre Kosova me organizimin e një bashkëbisedimi për pronësinë intelektuale. Z. Dukaj në këtë takim theksoi rëndësinë e mbrojtjes së pronësisë industriale për inovacionet e reja dhe përfitimet me rastin e mbrojtjes së tyre dhe ndikimi i IP në nxitjen e inovacionit dhe kreativitetit.




Promovimi i Pronësisë Industriale në Fakultetin Juridik të Universitetit "Hasan Prishtina" me studentet e këtij fakulteti. Profesoresha e nderuar Znj. Pllakolli mirëprit përfaqësuesit e institucioneve të pronësisë intelektuale në Kosovë. Z. Dukaj para studentëve foli për pronësinë industriale, përkufizimet dhe llojet e IP, dallimin në mes të këtyre llojeve dhe rëndësinë e mbrojtjes së pronësisë industriale.



Promovimi i Pronësisë Industriale para studentëve të kolegjit “Pjetër Budi”, Drejtori Dukaj foli mbi rëndësinë e regjistrimit të pronësisë industrial, procedurat e regjistrimit dhe rëndësia e konventave ndërkombëtare të pronësisë intelektuale.



Me organizimin ne Odës Ekonomike Gjermane të Kosovës u mbajt një tryezë e diskutimit për të drejtat e pronësisë intelektuale me bizneset anëtare të kësaj Ode. Në takim përveç Agjencisë morën pjesë dhe përfaqësuesit nga Zyra për të Drejtat e Autorit.



## 9. Forcimi i kapaciteteve administrative të Agjencisë, takimet rajonale

Me ftesë të Drejtorit të Entit Shtetëror të Pronësisë Industriale të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Z. Blerim Idrizi, një delegacion i kryesuar nga Drejtori i Agjencisë, Z. Dukaj, kryen një vizitë në zyret e Entit Shtetëror të Pronësisë Industriale.



Një delegacion i Agjencisë për Pronësi Industriale me mbështetjen e projektit LuxDev, qëndroi për një vizitë studimore në Entin Shtetëror për Pronësi Intelektuale të Republikës së Kroacisë. Gjatë vizitës, përmes teorisë dhe analizës së rasteve, u prezantua praktika e Entit lidhur me arsyet absolute dhe relative të refuzimit të regjistrimit të markës tregtare, arsyet e revokimit dhe pavlefshmërisë së një marke tregtare, markës së njohur tregtare dhe markës me reputacion. Gjithashtu, u prezantua edhe rregullimi ligjor lidhur me përfaqësimin e palëve në procedurat para Institutit dhe procedurën e dhënies së provimit për marrjen e statusit të përfaqësuesit të autorizuar.



Pjesmarrje në Konferenca Ndërkombëtare dy-ditore me temën “Women in Tradition, Innovation, Creativity and Entrepreneurship” e cila u mbajt në Tiranë me rastin e shënimit të 30 vjetorit të Drejtorisë së Pronësisë Industriale të Republikës së Shqipërisë.



Agjencia për Pronësi Industriale ka marrë pjesë në punëtorinë e organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Intelektuale në Shqipëri në muajin mars 2023, e cila është mbështetur nga TAIEK, me temën “Building Bridges between academia and industry in the field of intellectual property”.

U mbajt trajnimi për shqyrtimin e kundërshtimeve të markave tregtare për zyrtarët e Agjencisë gjatë muajit qershor. Ky trajnim u mbështet nga projekti LuxDev. Zyrtarët u trajnuar për zgjidhjen e çështjeve të kundërshtimeve nga trajnerja e angazhuar përmes LuxDev. Trajnimi zgjati 10 ditë pune.

Trajnim një ditor për Treguesit Gjeografikë dhe Emërtimet e Origjinës për zyrtarët e Agjencisë mbështetur nga projekti LuxDev, i mbajtur gjatë muajit qershor.

## 10. Të hyrat financiare

Agjencia realizon të hyra të cilat gjatë kësaj periudhe raportuese kanë qenë në shumën **410,697.60** euro. Për realizimin e këtyre të hyrave janë gjeneruar **7586** fletëpagesa. API ka sistemin e saj online të gjenerimit të fletëpagesave përmes web faqes së saj, ky shërbim ka mundësuar zvogëlimin e kohës për aplikimin dhe qasje në shërbimet e API-së.

Për këtë vit Agjencia për Pronësi Industriale ka rritur të hyrat për **2.84%**.



## 11. Të arriturat kryesore

1. Është përfunduar miratimi i infrastrukturës ligjore, me miratimin e 4 Udhëzimeve Administrative gjatë këtij viti është kompletuar pjesa legjislative në fushën e pronësisë industriale. **Ligjet e pronësisë industriale janë në përputhje të plotë me Aquies e BE;**
2. Rritja e numrit të regjistrimit të objekteve të pronësisë industriale për **50.38%**;
3. Rritje e numrit të dokumenteve zyrtare të lëshuara nga API për **30.03%**;
4. Progres në punën e stafit, me një rritje të efikasitetit për **21.34%**;
5. **27.23%** më shumë kundërshtime të shqyrtuara të markave tregtare;
6. Regjistrimi për here të pare i treguesve gjeografikë me pronar vendor, Djathi i Sharrit dhe Verëra e Rahovecit;
7. Rritja e të hyrave financiare të API-së për **2.84%**
8. Është rritur numri i objekteve industriale të publikuara në Buletinin Zyrtar për **418%**.

## **12. Donatorët**

Gjatë këtij viti Agjencia për Pronësi Industriale është mbështetur nga disa donator përmes programeve të tyre:

1. Technical Assistance by Luxembourg-Development – projekti mbështet disa aktivitete në forcimin e kapaciteteve.

## KONTAKTI



Agjencia për Pronësi Industriale  
Agencija za Industrijsku Svojину  
Industrial Property Agency

MINISTRIA E INDUSTRIJË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË

Adresa: Rruga "Arbënor e Astrit Dehari" nr. 21, 10000 Prishtinë / Republika e Kosovës

Website: [www.kipa.rks-gov.net](http://www.kipa.rks-gov.net)

E-mail: [infoapi@rks-gov.net](mailto:infoapi@rks-gov.net)

Tel: +383 38 200 36 554

Orari i pritjes: E hënë – E premte 08:00 - 16:00